

KONTRATË SHIT-BLERJE

Më datë 10/10/2023, nga dhe ndërmjet palëve, lidhet kontrata e mëposhtme:

SHITËSI: Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L42223008U, me seli në adresën: Tiranë, Rruga "Brigada 8", Pallati "Lid", Kati 7, Ap.Nr.21 dhe Nr.22, përfaqësuar nga aksionari i vetëm i shoqërisë "Anio Oil&Gas"sha, Z.Alban Peza, identifikuar nga letërnjoftimi me nr.037062716, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në vijim referuar si "Shitësi");

BLERËSI: Alban Peza, i biri i Gani-ut, lindur më 25.08.1970, në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 037062716, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me adresë: Tiranë, (në vijim referuar si "Blerësi").

Kushte të përgjithshme

- A. Shoqëria "Apsus"shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M21730029U dhe me seli në adresën: Tiranë, Rruga "Brigada 8", Ndërtesa Nr.4, Kati 7, Ap.Nr.21&Nr.22, (më tej referuar si "Shoqëria"). Kjo shoqëri përbëhet nga dy ortakë, të cilët janë pjesëmarrës në kapitalin e kësaj shoqërie si më poshtë:
1. Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, zotëruese e një kuote të barabartë me 80% (tetëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 80,000(tetëdhjetëmijë) Lekë.
 2. Z.Eldorado Merkoçi, zotërues i një kuotë të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.
- B. Shitësi deklaron se zotëron 1(një) kuotë të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, e barasvlefshme me 80%(tetëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 80,000(tetëdhjetëmijë)Lekë.
- C. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të blejë 20% të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "Apsus"shpk.
- D. Përfundimisht, pas nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes, shoqëria "Apsus"shpk do të përbëhet nga tre ortakë, secili me nga një kuotë, si më poshtë vijon:
1. Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 60%(gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 60,000(gjashtëdhjetëmijë) Lekë;
 2. Z.Eldorado Merkoçi, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;

3. Z.Alban Peza do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.
- E. Në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë “Apsus”shpk, nenin 73 “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave”, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.9901, dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë Shitblerje (në vijim referuar si “Kontrata”), me kushtet si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë të 20%(njëzetë përqind) të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë “Apsus”shpk. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me kapitalin në fjalë ndjekin kapitalin dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësit.

NENI 2

Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e 20% të kapitalit të shoqërisë është 20,000(njëzetëmijë) Lekë. Ky çmim do të paguhet nga Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate.
- 2.2 Çmimi do të paguhet nga Blerësi në favor të Shitësit nëpërmjet transfertës bankare në një nga llogaritë bankare të këtij të fundit.

NENI 3

Kalimi i titullit të pronësisë

- 3.1 Titulli i pronësisë së 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi kalon në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitblerje.

NENI 4

Efektet e shitjes

- 4.1 Palët bien dakord se pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe kalimit të titullit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësi, Shoqëria do të ketë këtë strukturë ortakësh:
- I. Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha do të jetë pronare e një (1) kuote të barabartë me 60%(gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 60,000(gjashtëdhjetëmijë) Lekë;
 - II. Z.Eldorado Merkoçi do të jetë pronar i një (1) kuote të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
 - III. Z.Alban Peza do të jetë pronar i një (1) kuote të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.

NENI 5

Garancitë e Palëve

5.1 Shitësi garanton Blerësin se:

- 5.1.1. Pjesët e kapitalit që ai zotëron në shoqëri dhe që janë objekt i shitblerjes sipas kësaj kontrate nuk janë subjekt barresimi, ndalimi shitje, të drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve.
- 5.1.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e pjesëve që ai zotëron në kapital dhe që janë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik.

5.2. Blerësi garanton Shitësin se:

- 5.2.1. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e 20% të kapitalit të Shoqërisë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj.

NENI 6

Konfidencialiteti

6.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohet në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.

6.2 Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:

- Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;
- Transmetimi bëhet në kuadër të përmbushjes së një detyrimi;
- Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik;
- Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
- Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

NENI 7

Komunikimi ndërmjet palëve

7.1 Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore në adresat e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.

7.2 Në rast se personat dhe/ose adresat e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën.

NENI 8
Ndryshimet e kontratës

8.1 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim dhe në nënshkruhet nga të gjitha palët në këtë Kontratë.

NENI 9
Interpretimi i kontratës

- 9.1 Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 9.2 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë i mundur qëllimeve të palëve.
- 9.3 Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 10.2 Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 11
Të tjera

- 11.1 Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:
- 12.1.1. Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;
 - 12.1.2. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shitësit;
 - 12.1.3. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë;
 - 12.1.4. Vendim datë 09/10/2023 i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Apsus" shpk.
- 11.2 Kjo kontratë është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese.
- 11.3 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

PALËT

SHITËSI
Shoqëria "Anio Oil&Gas" sha
Alban Peza


(emër, mbiemër, nënshkrim, vulë)



BLERËSI
Alban Peza


(emër, mbiemër, nënshkrim)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI AKSIONARE"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L42223008U			
2. Data e Regjistrimit	23/10/2014			
3. Emri i Subjektit	ANIO OIL&GAS			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	16/10/2014			
6. Kohëzgjatja	Nga: 16/10/2014 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Brigada 8", Pallati "LID", Kati 7, Ap.Nr.21 dhe Nr.22.			
8. Kapitali	12.606.000,000			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	12606000.0000			
10. Numri i aksioneve:	1.000,000			
10.1 Vlera nominale:	12.606,000			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Kryerja e aktivitetit të importit dhe eksportit, tregtimi me shumice e pakice të hidrokarbureve, karburante, biokarburanteve e lendeve të tjera të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi e licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj. Ndertimin i			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	impjanteve perpunuese te naftes dhe gazit natyror. Transportimi i hidrokarbureve, brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Shoqeria mund te themeloje, zoteroje pjesemarrje a kontrolloje shoqeri te tjera tregtare, apo te bashkepunoje, te lidhe marreveshje joint - venture ose marreveshje te ngjashme, me shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte apo te ngjashem me objektin e Shoqerise. Shoqeria mund te kryeje transaksione financiare, transaksione me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme si dhe te garantoje detyrimet e veta apo ato te paleve te treat duke vendosur mbi pasurite e saj garanci te ndryshme sipas parashikimeve ligjore. Zhvillim dhe prodhim i hidrokarbureve ne vendburimin Ballsh-Hekal, sipas Marreveshjes ndermjet Shoqerise Albpetrol sh.a dhe Shoqerise Stream Oil & Gas Limited (sot Transatlantic Albania LTD) date 19/07/2007 dhe transferuar me Instrument Transferimi date 02/05/2018.	
13. Sistemi i administrimit	☒ me një nivel ☐ me dy nivele	
14. Administratori/ët	Alban Peza	
14.1 Afati i emërimit	Nga: 09/01/2018	Deri: 05/01/2024
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).		
16. Anëtarët e Këshillit të Administrimit (plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)	Flamur Gishto	
16.1 Kryetar/anëtar	Kryetar	
16.2 Afati i emërimit	Nga: 05/01/2018	Deri: 04/01/2024
17. Anëtar i Pavarur	Po	
17.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo	
17.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
19. Anëtarët e Këshillit të Administrimit (plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)	Nevila Kullojka	
19.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
19.2 Afati i emërimit	Nga: 23/12/2019	Deri: 04/01/2024
20. Anëtar i Pavarur	Po	
20.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

20.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
22. Anëtarët e Këshillit të Administrimit (plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)	Klarinda Elmasllari
22.1 Kryetar/anëtar	Anetar
22.2 Afati i emërimit	Nga: 05/01/2018 Deri: 04/01/2024
23. Anëtar i Pavarur	Po
23.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo
23.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
25. Aksionarët	Alban Peza
25.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote: 1000.0000 Pa te drejte vote:
25.2 Përqindja e pjesëmarrjes	100,000
26. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Ballsh BALLSH Vendburimi Ballsh-Hekal, Ballsh, mallakaster, Qarku Fier.
27. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ANIO E-Mail: nevila.kullojka@anio.al sekretaria@anio.al Telefon: +35544330211
28. Statusi:	Aktiv

Datë: 10/10/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2023/10/10 09:27:57 +02:00
L42223008U2023101009274772
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M21730029U
2. Data e Regjistrimit	30/05/2022
3. Emri i Subjektit	A P S U S
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	16/05/2022
6. Kohëzgjatja	Nga: 16/05/2022
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Brigada 8", Ndërtesa Nr.4, Kati 7, Ap.Nr.21&Nr.22
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Investim me pjesëmarrje, blerje, shitje, në kuota, aksione dhe tituj të tjerë në shoqëritë tregtare. Shoqëria mund të marrë pjesë me financime të zotërojë, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi. Investimi në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të trete (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, etj.) në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Shitblerja e mallrave të ndryshme. Shitblerje e pasurive të paluajtshme. Ndërmjetësime financiare. Ndërmjetësime në fushën e industrisë së naftës dhe gazit. Të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie e marrje me qira. Të kryejë çdo aktivitet tjetër fitimprurës në përputhje me legjislacionin shqiptar në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	fuqi. Të kryejë çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e erës, termocentralet, biomasa etj. - Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji, si dhe i veprave të tyre ndihmëse, përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare nga institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit. Përveç sa më sipër, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mësipërm. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipotekë, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe çdo aktivitet aksesor i lidhur me sa më sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të tokës, punime civile, elektrike dhe mekanike të çdo lloji si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto çështje, gjithashtu dhe në fushën e aktiviteteve të tregtimit.	
10. Administratori/ët	Miken Dervishi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/05/2022	Deri: 15/05/2027



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	EldoradoMerkoçi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 20.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	20,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	ANIO OIL&GAS	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 80.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	80,00	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Ballsh BALLSH Rruga "Mehmet Shehu", Ish TEC Armo, Zona Kadastrale nr. 1090	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: APSUS E-Mail: mikndervishi@gmail.com Telefon: 0692796296	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 10/10/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2023/10/10 09:28:50 +02:00
M21730029U2023101009284032
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

Shoqëria "Apsus"shpk
Nuis: M21730029U
Selia: Tiranë, Rr."Brigada 8", Ndërtesa Nr.4,
Kati 7, Ap.Nr.21&Nr.22

VENDIM DATË 09/10/2023
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "APSUS"SHPK

Sot, më datë 09/10/2023, ora 11:00, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Apsus"shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Nuis M21730029U. Në këtë mbledhje janë të pranishëm personalisht të dy ortakët:

- Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, e cila zotëron 80% të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, përfaqësuar personalisht nga Aksionari i saj i vetëm Z.Alban Peza, i cili zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë "Anio Oil&Gas"sha;
- Z.Eldorado Merkoçi, i cili zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk.

Në bazë të nenit 86 dhe 87 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.


Rendi i ditës është si më poshtë:

1. Miratimi i shitjes nga shoqëria "Anio Oil&Gas"sha të 20%(njëzetë përqind) të kapitalit që shoqëria "Anio Oil&Gas"sha zotëron tek shoqëria "Apsus"shpk me NUIS M21730029U, në favor të Z.Alban Peza, sipas Kontratës së shitjes dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratën që do lidhet ndërmjet palëve për këtë qëllim;
2. Të ndryshme.

Duke qenë se ortakët e konsiderojnë të shteruar të drejtën e parablerjes, përse më sipër, ortakët unanimisht, pasi shqyrtuan rendin e ditës,

VENDOSËN:

1. Të miratojnë shitjen nga shoqëria "Anio Oil&Gas"sha të 20%(njëzetë përqind) të kapitalit që shoqëria "Anio Oil&Gas"sha zotëron tek shoqëria "Apsus"shpk me NUIS M21730029U, në favor të Z.Alban Peza sipas Kontratës së shitjes dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratën që do lidhet ndërmjet palëve për këtë qëllim.
2. Përfundimisht, pas nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes, struktura e kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk do të jetë si më poshtë vijon:
 - i. Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 60%(gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 60,000(gjashtëdhjetëmijë) Lekë;



- ii. Z.Eldorado Merkoçi, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
- iii. Z.Alban Peza do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha
Përfaqësuar nga Aksionari i vetëm
Alban Peza



Eldorado Merkoçi